



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Kryetarja

Nr. 677 Prot.

Tiranë, më 20.02.2024

URDHËR

Nr.10, datë 20.2.2024

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 22.2.2024 ORA 10:00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 5 shkurt – 23 shkurt 2024,

URDHËROJ:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancën plenare të datës 22.2.2024, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 15.2.2024.
 2. Njoftime.
 3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore “CEEPUS IV”.
 4. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”.
 5. Projektligji “Për dhënie amnistie”.
 6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura””.
 7. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.
- III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.
- IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Lindita NIKOLLA





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 22 shkurt 2024, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrorit nr. 10, datë 20.2.2024 të Krytares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 15.2.2024.
(Neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime
(Neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)
3. **Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes në lidhje me programin e shkëmbimit të studimeve universitare në Evropën Qendrore “CEEPUS IV”.**
(Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.
Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.
Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit
4. **Projektligjit “Për ratifikimin e protokollit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Italiane, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”**
(Në mbështetje neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

5. **Projektligj "Për dhënie Amnistie"**

(Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, shkronja "ë", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë të cilësuar votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

6. **Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017 "Për zonat e mbrojtura"**

(Në mbështetje të neneve 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 68 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

7. **Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.**

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)